

VENDIM
Nr. 497, datë 27.7.2022

**PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE
RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR PËR
ZHVILLIMIN RAJONAL DHE KOHEZIONIN**

(Ndryshuar me VKM nr. 357, datë 20.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 17, të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, këtu e në vijim “KKZHRK”, si dhe miratimin e përbërjes, mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij.

2. KKZHRK-ja është organ ndërinstitucional, përgjegjës për hartimin, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin e politikës së zhvillimit rajonal, si dhe koordinimin e zbatimit të masave të ndërmarra në kuadër të programit operacional për zhvillimin rajonal.

3. KKZHRK-ja ka stemën e vet zyrtare.

4. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

II. KOMPETENCAT, PËRBËRJA DHE DREJTIMI I KKZHRK-së

1. KKZHRK-ja ka këto kompetenca:

a) harton dhe miraton paraprakisht politikën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) harton dhe miraton paraprakisht Planin Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) shqyrton dhe miraton paraprakisht planet rajonale të zhvillimit rajonal dhe kohezionit, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) harton dhe miraton paraprakisht Programin Operacional për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) miraton metodologjinë dhe kriteret që do të përdoren në përzgjedhjen e projekteve të zhvillimit, në kuadër të programit operacional;

dh) miraton rregullat dhe procedurat për monitorimin e vlerësimin e planeve rajonale për zhvillimin rajonal dhe kohezionin;

e) monitoron zbatimin e Politikës Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;

ë) harton dhe miraton raportet vjetore për aktivitetin e saj, të cilat i paraqiten Këshillit të Ministrave;

f) harton dhe miraton rregulloren e brendshme, që lidhet me aspekte administrative dhe/ose teknike të veprimtarisë së saj.

2. KKZHRK-ja drejtohet nga zëvendëskryeministri, në cilësinë e kryetarit.

3. Përbërja e KKZHRK-së do të jetë e njëjtë me përbërjen e këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Anëtarë të KKZHRK-së janë anëtarët e këshillit drejtues të FSHZH-së, të emëruar sipas përcaktimeve të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Kryetari i KKZHRK-së është përgjegjës, për:

a) organizimin e punës dhe aktivitetin e KKZHRK-së para Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave;

b) thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve të KKZHRK-së;

c) miratimin e rendit të ditës së mbledhjeve të KKZHRK-së;

ç) koordinimin e punës së BMZHR-ve;

d) krijimin e grupeve të punës për çështje që konsiderohen me interes për zhvillimin rajonal.

7. *Shfuqizuar.*

III. VENDIMMARRJA DHE VEPRIMTARIA

1. Secili anëtar i KKZHRK-së shpreh qëndrimin e institucionit që ai përfaqëson. Çdo mendim merret parasysh dhe diskutohet.

2. Vendimet e KKZHRK-së i nënshtrohen një procesi shqyrtimi dhe diskutimi midis anëtarëve për çdo propozim apo çështje për diskutim.

3. Vendimet e KKZHRK-së miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, të cilët nuk kanë të drejtë abstenimi. Kryetari voton i fundit dhe, në rast barazie, vota e tij është vendimtare.

4. Vendimet e KKZHRK-së përmbajnë numrin, datën, nënshkrimin e kryesuesit të mbledhjes dhe të sekretariatit teknik.

5. Vendimet e miratuara u komunikohen anëtarëve të KKZHRK-së dhe pjesëmarrësve pa të drejtë vote nga sekretariati i KKZHRK-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e mbledhjes.

6. KKZHRK-ja zhvillon veprimtarinë e saj nëpërmjet mbledhjeve të zakonshme dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme.

7. Mbledhjet e KKZHRK-së janë të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm minimalisht 2/3 e anëtarëve, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari.

8. Organizimi i mbledhjeve dhe modalitetet teknike të zhvillimit të tyre përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga KKZHRK-ja.

9. Në mbledhje marrin pjesë përfaqësues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me cilësinë e autoritetit menaxhues dhe të sekretariatit teknik të këtij Komiteti.

10. *Në varësi të rendit të ditës, me propozim të kryetarit, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e KKZHRK-së përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, përfaqësues nga bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal (BMZHR), të ngritura në përputhje me ligjin nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin", përfaqësues të shoqatave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, përfaqësues të donatorëve, të institucioneve të Bashkimit Evropian ose aktorë të tjerë të zhvillimit rajonal.*

11. Pjesëmarrësit pa të drejtë vote në mbledhjet e KKZHRK-së mund të bëjnë propozime, të cilat KKZHRK-ja mund t'i diskutojë dhe t'i hedhë për votim.

IV. SEKRETARIATI TEKNIK DHE MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE

1. Rolin e sekretariatit teknik e kryen struktura përgjegjëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, e përcaktuar me urdhër të drejtorit ekzekutiv të këtij institucioni.

2. Sekretariati teknik koordinon dhe mbështet punën e KKZHRK-së për përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të parashikuara, në përputhje me ligjin nr. 102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin".

3. Sekretariati teknik kryen këto detyra:

a) Mundëson proceset dhe përgatitjen e dokumenteve strategjike, të:

i. Politikës Kombëtare të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit;

ii. Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;

b) Njofton organizimin e mbledhjeve të KKZHRK-së sipas rendit të ditës dhe përgatit dokumentacionin e nevojshëm, që i vihet në dispozicion paraprakisht anëtarëve;

c) Harton procesverbalin e mbledhjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) Mban një regjistër të posaçëm për vendimet e KKZHRK-së;

- d) Siguron regjistrimin dhe arkivimin e dokumenteve të KKZHRK-së;
- dh) Siguron publikimin e dokumenteve të KKZHRK-së sipas ligjit;
- e) Me kërkesë të kryetarit të KKZHRK-së harton analiza në lidhje me veprimtarinë e BMZHR-ve, në bazë të raporteve të veprimtarisë së paraqitur prej tyre;
- ë) Kryen detyra të tjera që mund t'i delegohen nga KKZHRK-ja ose kryetari i KKZHRK-së, sipas përcaktimeve në ligj.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. *Shfuqizuar.*
2. *Shfuqizuar.*
3. Ngarkohen KKZHRK-ja dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj